



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit Korporata Energjetike e Kosovës OE ankues NTP "SNR"	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP Nr. 262/19
Prej:	Ekspert shqyrtues i prokurimit Muhamet Kurtishaj		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.262/19 të parashtruar nga OE NTP "SNR" me seli ne Prishtinë për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë" me nr.prokurimi KEK-19-292-111		
Datë	17.05.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt:30.05.2019 me nr.262/19 të parashtruar nga OE **NTP "SNR"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë"** me nr.prokurimi KEK-19-292-111, të iniciuar nga autoriteti kontraktues **Korporata Energjetike e Kosovës**.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Raporti i ekspertit shqyrtues për ankesën e parashtruar nga OE **NTP "SNR"** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë"** me nr.prokurimi KEK-19-292-111, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Korporata Energjetike e Kosovës**.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	07.06.2019	17.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit	data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 30.5.2019 OE NTP "SNR" Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Newko Balkan L.L.C" lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë" me nr.prokurimi KEK-19-292-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Korporata Energjetike e Kosovës.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues NTP "SNR" Prishtinë

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues janë:

- Neni 57- Sigurimi i tenderit.
- Neni 59 – Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve.
- Neni 65 – Pranueshmeria e kandidateve dhe tenderuesve.
- Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë.
- Neni 29 RRUOPP - Sigurimi i tenderit
- Neni 39 RRUOPP - Sqarimi i tenderit
- Neni 6 FO3- Pezullimi i aktivitetit të prokurimit

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Me datën 15.05.2019, Autoriteti Kontraktues- ne platformen e E-prokurimit ka bërë publikimin e Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për shpërblym me kontratë dhe Letren Standarde për Tenderuesin e Suksesshem dhe Letrat Standarde për Tenderuesit e pa suksesshem. Sipas këtij vendimi Autoriteti Kontraktues ka shpërblyer me kontratë Operatorin Ekonomik NEWKO BALKAN L.L.O nga Suhareka me gimin total prej **4,400,683.74 C**.

Me datën 15.05.2019 nga Autoriteti Kontraktues kemi kërkuar qasje në dokumentet e tenderit. Nga Autoriteti Kontraktues na është lejuar qasja në dokumentet e tenderit dhe me datën)

16.05.2019 ne ora 14:30 kemi qene ne qasje te tenderit ne lokalet e Autoritetit Kontraktues. Kemi kerkuar kopje te dokumentacionit te tenderit dhe ngz AK kemi pranuar dokumentacionin e tenderit ne menyre elektronike. Pas shfletimit dhe analizimit te ofertes se Operatorit Ekonomik qe Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar qe te shperblehet me kontrate, kemi verejtur se Autoriteti Kontraktues me vendimin qe ka marre per shperblim me kontrate Operatorin Ekonomik "NEWKO BALKAN L.L.O nga Suhareka, ka bere shkelje substanciale te legjislacionit primar dhe sekondar te prokurimit publik ne Republiken e Kosoves pasi qe ka shperblyer me kontrate Operatorin Ekonomik i cili ka dorezuar oferte te pa pergjegjshme.

Oferta e Operatorit Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.O nga Suhareka nuk i ploteson 1 (to kritere te kerkuara nga Autoriteti Kontraktues:

1. Kerkesat e pershtatshmerise: Nje deklarata nen Betim, e nenshkruar nga tenderuesi duke perdorur former) e percaktuar ne dosjen e tenderit- Aneksi 2. Ne paragrafin e pare te Deklarates shenon:

"Line, i poshte nenshkruari, duke perfaqesuar: *[operatorin ekonomik qe paraqitet]* deklaroj nen betim se jam i pershtatshem ne perputhje me Nenin 65, te Ligjit te Prokurimit Publik ne Kosove Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092".

Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" se bashku me oferten ka dorezuar Deklaraten nen Betim por nuk e ka plotesuar ashtu sic kerkohet ne former) e percaktuar ne Aneksit 2 te dosjes se tenderit. Nuk e ka shenuar emrin e Operatorit Ekonomik qe perfaqeson ne paragrafin e pare te Deklarates. — Deshmia 1- shikoj liëkiaraten nen Betim Operatori Ekonomik ka dorezuar se bashku me oferten.

Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka se bashku me oferten ka dorezuar Sigurimin e tenderit te leshuar nga Banka Kombetare Tregtare, Njesia Prizren me daten 21 Mars 2019.

Sigurimi i tenderit qe Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka ka dorezuar se bashku me oferten nuk i ploteson kerkesat e Autoritetit Kontraktues ashtu sic kerkohen ne nenin 57 te ligjit nr. 04/L-042 per Prokurimin Publik te Republikes se Kosoves, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenin 29. Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ per Prokurimin Publik, Kerkesat ne Dosje te Tenderit- Seksioni I. INFORMACIONE PER TENDERUESIT dhe Aneksit 4 — Sigurimi i Tenderit te bashkangjitur ne Dosjen e Tenderit te ketij aktiviteti te prokurimit.

Sigurimi i tenderit qe Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka ka dorezuar se bashku me oferten, eshte jo valid pasi qe i mungojne shumica e te dhenave te kerkuara ne Aneksin 4- te Dosjes se Tenderit. Ajo qe eshte esenciale per mangesite qe ka ky garancion eshte se i mungojne klauzolat e kushteve te konfiskimit te Sigurimit te Tenderit. Kjo e bene Sigurimin e Tenderit te pa realizueshem per Autoritetin Kontraktues ne rast te kerkeses se tij per konfiskim per mospermbushjen e Operatorit Ekonomik te njerit nga kushtet e specifikuara ne Aneksin 4- Sigurimi i Tenderit dhe legjislacionin e citur me larte. Deshmia 2- shiko Sigurimin e Tenderit oe Operatori Ekonomik ka rezuar se bashku me oferten,

Autoriteti Kontraktues- korporata Energjetike e Kosoves, gjate vleresimit te ofertave ne fazen e pare — vleresimi administrativ, eshte dashur qe ti vereje keto leshime substanciale te ketij sigurimi te ofertes dhe kete sigurimin te ofertes ta konsideroje si Jo valid , te mos vazhdoj tutje me fazat tjera te vleresimit te ofertes dhe oferten e Operatorit Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka ta konsideroje si oferte te pa pergjegjshme dhe ta eliminoj nga aktivitetet i prokurimit.

Deshmi shtese te chat deshmojne se Autoriteti Kontraktues — Korporata Energjetike e Kosoves, ka bere shkelje rlstanciale ge Sigurimin e Tenderit te Operatorit Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.O nga Suhareka e ka konsideruar si valid dhe ka rekomanduar qe te shperblehet me kontrate.

Kemi shfletuar ueb faqen e Organit Shqyrtues te Prokurimit dhe gjate shfletimit te vendimeve te Paneleve Shqyrtuese te Prokurimit Publik kemi hasur ne Vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.nr. 373/17 te dates 07.11.2017 ku ka te beje me nje rast te njejte kur Sigurimi i Tenderit nuk eshte dorezuar ne harmoni nenin 57 te LPP dhe Aneksin 4 te qene ne harmoni me nenin 57 te LPP dhe Aneksin 4- te Dosjes se Tenderit. Autoriteti Kontraktues, automatikisht kete sigurim te ofertes e ka konsideruar si jo valid, oferten e ka konsideruar te pa pergjegjshme dhe Operatorin Ekonomik e ka anuluar nga aktiviteti i prokurimit. Operatori Ekonomik i eliminuar pas refuzimit te kerkeses per Rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues eshte anuluar ne Organin Shqyrtues te Prokurimit. Eksperti shqyrtues por edhe Paneli Shqyrtues , ankesen e ketij OE e kane konsideruar si te pa bazuar pasi qe se bashku me oferten ka dorezuar Sigurimin e Tenderit i cili nuk eshte sipas nenit 57 te LPP dhe Aneksit 4- te Dosjes se Tenderit. Vlen te theksohet se oferta e Operatorit Ekonomik ankues ka qene mbi **500,000.00 € me e lire** se oferta e Operatorit Ekonomik qe Autoriteti Kontraktues e ka shperblyer me kontrate, por per shkak te mangesive qe ka pasur ne Sigurimin e Ofertes, eshte eliminuar nga Autoriteti Kontraktues dhe ankesa i eshte refuzuar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Gjithashtu me daten 29.05.2019, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka publikuar Vendimin PSH. nr. 184/19. Sipas te dhenave te shenuara ne kete vendim shihet se nje Operator Ekonomik ka dorezuar Sigurimin e Tenderit i cili nuk ka qene ne harmoni me nenin 57 te LPP dhe Aneksin 4- te Dosjes se Tenderit. Autoriteti Kontraktues, kete sigurim te ofertes e ka konsideruar si Jo valid, oferten e ka konsideruar te pa pergjegjshme dhe Operatorin Ekonomik e ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. Operatori Ekonomik i eliminuar pas refuzimit te kerkeses per Rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues eshte ankuar ne Organin Shqyrtues te Prokurimit. **Paneli Shqyrtues , ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues me te drejte e ka eliminuar operatorin ekonomik sepse sigurimi i tenderit i dorezuar nga ky operator ekonomik ne platformen elektronike nuk eshte dorezuar ne formen e kerkuar nga Autoriteti kontraktues, dhe si i tille nuk permbushe kerkesen e Autoritetit Kontraktues per dorezimin e sigurimit te tenderit sipas Aneksit 4. Deshmia 3A dhe 3B. Shiko vendimin PSH.nr.373/17/19 te dates 07.11.2017 dhe vendimin PSH.nr.184/19 te dates 29.05.2019**

4. Deklaratat e kerkuara ne Fleten e te Dhenave (FDT) dhe Aneksin 1- Specifikimet Teknike te Detyrueshme.

Kerkesat e Autoritetit Kontraktues:

Sektori 11 FLETA E TE DHENAVE TE TENDERIT (FTD)

Neni 3.1 i FDT- Specifikacionet teknike te detyrueshme

Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentet deshmuese per qellimin e ofruar te kontrates, duke perfshire:

Dpklaraten per specifikacionet teknike per mallrat e ofruara te cilat perputhen me ato te permendura ne Aneksin 1 te dosjes se tenderit.

Aneksi 1.SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUESHME

Me oferte duhet te dorezohen edhe keto dokumente:

Deklarate e ofertuesit mbi afatin e jo me larg se 40 dite prej leshimit te porosise nga Autoriteti Kontraktues

Deklarate mbi afatin e garancionit liferimit prej te shiritit 3 (tre) vite, nga data e montimit ne konstruksion.

Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka se bashku me oferten ka dorezuar:

Deklaraten e Specifikave Teknike — (Deklarate- Kushtet e Liferimit), por ne kete deklarate ka shenuar dhe ju ka referuar aktivitetit te prokurimit me numer: KEK19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka derguar oferten. Deshmia 4 - shiko Deklaraten qe Operatori Ekonomik e ka dorezuar se bashku me oferten.

- Deklaraten e Liferimit- por ne kete deklarate ka shenuar dhe ju ka referuar aktivitetit te

prokurimit me numer: KEK-19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka derguar oferten. Deshmia 5 - shiko Deklaraten qe Operatori Ekonomik ka dorezuar se bashku me oferten,

- Deklaraten e Garanciaonit - por ne kete deklarate ka shenuar dhe ju ka referuar aktivitetit te prokurimit me numer: KEK-19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka derguar oferten. Deshmia 6 - shiko Deklaraten qe Operatori Ekonomik ka dorezuar se bashku me oferten.
- Deklaraten e Standardit DIN:22102- por ne kete deklarate ka shenuar dhe ju ka referuar aktivitetit te prokurimit me numer: KEK-19-125-121 qe nuk ka te beje fare me numrin e aktivitetit te prokurimit ne te cilin ka derguar oferten. Deshmia 7 shiko Deklaraten qe Operatori Ekonomik ka dorezuar se bashku me oferten prodhimi i shirtave te behet sipas Standardit DIN:22102 ose ekuivalent.
- Nga te dhenat e publikuara ne Platformen e E-prokurimit, shihet se aktiviteti me numer te prokurimit: **KEK-19-125-121**, ka te beje me aktivitetin e prokurimit: **Furnizim me shirit gome per transporter te zgures**. Deshmia 8 - **shiko Njoftimin per Nenshkrimin e Kontrates te dates 08.04.2019**.
- Nga keto te dhena shihet se te gjitha deklaratat e shenuara me larte e te chat i ka dorezuar Operatori Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" se bashku me oferten per aktivitetin me numer te prokurimit: **KEK-19-292-111,- Furnizim me shirit transportues gorne-pelhure** jane te pavlefshme dhe nuk i plotesojne kerkesat e Autoritetit Kontraktues.

Shkeljet qe ka bere Autoritetit Kontraktues pas pranimit te Kerkeses per Rishqyrtim dhe dergimit ti venuimit - pergjigjes te OE ankues

Pershkrim i nenit 6 -Pezullimi i aktivitetit te prokurimit te F03

6.1 Ushtrimi i kerkeses per rishqyrtim automatikisht pezullon proceduren e prokurimit dhe ne kete rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit, duhet te njoftoj me shkrim te gjitha palet e interesuara lidhur me pezullimin e procedures se prokurimit ne fjale.

Autoriteti Kontraktues — Korporata Energjetike e Kosoves ka bere shkelje substanciale te nenit 6 paragrafi 6.1 te F03- Rregullat per Parashtrim te Ankesave. Pas pranimit te Kerkeses per Rishqyrtim nga kompania jone, fare nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit dhe nuk ka marre asnje veprim per ti informuar Operatoret Ekonomik lidhur me pranimin e Kerkeses per Rishqyrtim.

Pershkrim i Neni 72 te LPP - Dokumentacioni dhe informacioni shtese

2- Autoriteti kontraktues mund te ftoje operatoret ekonomik per te plotesuar apo te qartesoje certifikatat dhe dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te ketij ligji.

Pershkrim nenit 39. Sqarimi i Tendereve te RRUOPP

39.3 Megjithate, lejohet qe nje autoritet kontraktues gjate vleresimit te kerkoj dhe te marre informacione apo dokumente, te chat mungojne ne aplikacionnender. Keto dokumente, megjithate, **ne menyre objektive duhet te prezantojne se kane ekzistuar para afatit te fundit te dorezimit te aplikacionit apo te dorezimit te tenderit**. Pervec kesaj, kerkesa nuk do te duhej qe te favorizoj apo demtoj padrejtesisht ofertuesin perkates.

39.5 Autoriteti kontraktues mund te ftoje operatoret ekonomik per te plotesuar apo te qartesojne certifikatat dhe **dokumentet e paraqitura ne pajtim me nenet 65-71 te LPP-se** d.m.th deshmite e dorezuara per kerkesat e pershtatshmerise, kerkesat e pershtatshmerise profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftesise teknike dhe profesionale, certifik „c. e kualitetit, kerkesa te grupeve te OE.

Autoriteti Kontraktues se bashku me Vendimin per refuzim te kerkeses per rishqyrtim te dates 02.05.2019 na ka derguar keto dokumente te cilat kane te bejne me Operatorin Ekonomik qe AK ka propozuar qe te shperblehet me kontrate- " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka:

- **Leter Standarde e Kerkeses per Sqarimin e Tenderit**, e cila nuk ka date te shenuar se kur eshte hartuar dhe kur eshte derguar te OE. Deshmia 9
 - **Shkrese — sqarimet** e derguara nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e dates 24.04.2019. Deshini.10
 - **Deklarate — Liferimi** e derguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e dates 24.04.2019- eshini.11
 - **Deklarate- Grancioni** e derguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e dates 24.04.2019- Deshini.12
 - **Deklarate — Kushtet e Liferimit** e derguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e dates 24.04.2019- Deshini.13
 - **Deklarate Standardet** e derguar nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" e dates 24.04.2019- Deshmia 14
- Nga keto dokumente te cilat Autoriteti Kontraktues na i ka derguar se bashku me Vendimin e refuzimit te Kerkeses per Rishqyrtim te dates 22.05.2019, shihet se g.jate fazes se vleresimit dhe qasjes ne dokumentet e tenderit , Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje substanciale te nenit 10 te LPP, nenit 59 te LPP, nenit 72 te LPP dhe nenit 39 te A01- RRUOPP.

Kur ne kemi gene ne qasje te dokumenteve te tendent Autoriteti Kontraktues nuk na i ka prezantuar keto dokumente te cilat na i ka derguar se bashku me vendimin e refuzimit te kerkeses per Rishqyrtim. Kjo deshmon AK nuk na ka lejuar qasje te plote ne dokumentet e tenderit ashtu sic e lejon nenin 10 i LPP. Gjate fazes se vleresimit Autoriteti Kontraktues ka kerkuar sqarime shtese nga OE " NEWKO BALKAN L.L.C" per dokumente te cilat Operatori Ekonomik se bashku me oferten veg i ka dorezuar, por te chat ju kane referuar nje aktiviteti tjeter te prokurimit te Autoritetit Kontraktues — Korporata Energjetike e Kosoves. Prandaj AK nuk ka pasur te drejte te kerkoj informata sqaruese per digka qe shume qarte ka shenuar ne keto dokumente te pranuar se bashku me oferten— numri i prokurimit- **KEK-19-125-121** e jo ashtu sic eshte dashur ta shenoje, **KEK-19-292-111**. Numri i prokurimit eshte shume me rendesi pasi qe gdo aktivitet i prokurimit identifikohet permes numrit te prokurimit te cilin automatikisht e gjeneron platforma e e-Prokurimit per gdo aktivitet te prokurimit.

Dokumentet per te chat Autoriteti Kontraktues ka kerkuar sqarime shtese Jane kerkesa te te paraqitura ne Aneksin 1 — Specifikat Teknike te Detyrueshme te Dosjes se Tenderit sipas nenit 28 te LPP dhe nuk kane te bejne fare me nenin 65 den i 71 te LPP. Bazuar ne kete fakt, Autoriteti Kontraktues sqarimet shtese nga OE i ka kerkuar ne kundershtim me nenin 59 te LPP, nenit 72 te LPP dhe nenit 39 te A01- RRUOPP;

Operator' Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka se bashku me sgarimin, me daten 24.04.2019 lca derguar te Autoriteti Kontraktues: Deklarate — Liferimi, DeklarateGrancioni, Deklarate — Kushtet e Liferimit dhe Deklarate- Standardet, te cilat kane te shenuara dater) 24.04.2019. Konsiderimi i ketyre Deklaratave si valide nga Autoriteti Kontraktues, eshte ne kundershtim te plote me nenin 39.3 i A01- Rregullat dhe Udhezuesi Operativ i Prokurimit Publik. Bazuar ne kete dispozite asnje nga dokumentet ge nuk deshmohet se kane ekzistuar para afatit te fundit te dorezimit te tenderit qe ne kete aktivitet te prokurimit ka gene data 28.03.2019, nuk munde te konsiderohen Si dokumentacion valid.

Bazuar ne te gjitha mangesite e cekura me larte, shihet se Autoriteti Kontraktues — Korporata Energjetike e Kosoves me vendimin qe ka marre per te shperblyer me kontrate Operatorin Ekonomik " NEWKO BALKAN L.L.C" nga Suhareka i cill per kete aktivitet te prokurimit ka dorezuar oferte te pa pergjegjshme ka bere shkelje substanciale te dispozitave te legjislacionit primar dhe sekondar te prokurimit publik te shenuara me larte.

Prandaj , kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit qe te merre per baze ankesen tone per dhe lenden ta ktheje ne **Ri-vleresim**.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë:	05.02.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....	Kontratë publike Komune –Furnizim
Vlera e parashikuar ke kontratës:.....	5 100.000,00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....	tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....	28.03.2019
Data e hapjes së ofertave.....	28.03.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave.....	13.05.2019
Data e njoftimit me letër standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm	15.05.2019
Data e njoftimit për dhënien e kontratës:.....	15.05.2019
Data e kërkesës për rishqyrtim.....	20.05.2019
Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....	22.05.2019

Kriteret për vlerësim:

Çmimi më i lirë

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1 Kërkesat e përshtatshmërisë

1. Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit nr.04/L-042 Neni 65.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve të paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohe vetëm për fituesin e tenderit.
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e përshtatshmërisë" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – original ose kopje e noterizuar .- kërkohe vetëm për fituesin e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë, pika 2, dhe 3 do të kërkohe nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH; në vendin e themelimit
3. Regjistrimi i numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend /Kopja e certifikatës së biznesit);
2. Kopja e certifikatës TVSH-se;
3. Kopja e certifikatës numrit fiskal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Autenticiteti i produkteve dhe cilësisë reprezentuese
2. Çertifikate të produktit në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet
3. Katalog, përshkrime, fotografi etj.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi të sillet kontratë ose autorizim mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve që ofroni.
2. Certifikata nga prodhuesi sipas ISO 9001 dhe ISO 14001.
3. Dokumentacioni autentik i prodhuesit si katalogë pjesë të katalogut nga prodhuesi dhe apo vizatim të vërtetuar nga prodhuesi me përshkrim teknike detale për artikujt që oferton. Në katalog pjesë të katalogut dhe apo vizatim sipas specifikimeve teknike të kërkuara të nënvizohen artikujt për pozicionet e kërkuara.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €	Vërejtje
1.	"Newko Balkan L.L.C"	Suharekë	4.400.683,74 €	Jo
2.	"Bindi" SH.P.K	Tiranë	4.597.923,34 €	Jo
3.	"SNR "	Prishtinë	4.482,903,07 €	Jo
4.	"Tech 1 & Kale"	Mitrovicë	4.885.061,94 €	Jo
5.	"Xani-Inex"	Prishtinë	4.795.737,12 €	Jo
6.	"Ekoinvest"	Prishtinë	5.384.467,44 €	Jo

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Afrim Imeraj – Kryetar i komisionit
- Ramadan Shalaku – Anëtar i komisionit
- Driton Bytyqi – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për dhenie të kontrates:

- "Newko Balkan L.L.C" me vlerën e ofertes prej **4.400.683,74 €**

Deklaratë:

Komisioni i vlerësimit pas Ekzaminimit, Vlerësimit dhe Krahësimit të Tenderëve si dhe pas sqarimeve për aktivitetin e prokurimit KEKO-19-056-111 **"Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë"** konstaton se 6 oferta janë pranuar, të gjitha të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara sipas dosjes së tenderit dhe informative plotësuese sqaruese të publikuara para hapjes së ofertave, ndërsa propozon që oferta e OE **"Newko Balkan L.L.C"** si oferta më e lirë të pranuar të shpërblehet me kontratë për këto aktivitete të prokurimit. Komisioni i vlerësimit deklaron se aktiviteti i prokurimit është udhëhequr duke respektuar dispozitat e LPP-së dhe RRUOPP.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "SNR" Prishtinë

Përgjigje në Pretendimin nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e pershtatshmerise sepse Deklaraten ne betim nuk e ka plotësuar si duhet, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

OE i rekomanduar për kontratë të paraqitur në platformën elektronike formularin standart Aneksin 2 te dosjes se tenderit dhe i njeti eshte i plotësuar si duhet. I permbane te gjitha te dhenat e nevojshme te operatorit ekonomik. Eshte i nenshkruar dhe vulosur ne emer te kompanise dhe si i tille i plotëson kushtet e nevojshme si dokument valid. Si i tille eshte i pranueshme dhe ne perputhje me kërkesat e dosjes se tenderit. Prandaj ky pretendim ankimor eshte i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin nr.2

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se sigurimi i ofertës se operatorit ekonomik te rekomanduar për kontrate nuk eshte bere ne përputhje me nenin 57 te LPP-se dhe Ankesin 4 te Dosjes se tenderit sepse sigurimi i nxjerre nga Banka Kombetare Tregtare (BKT) i mungojnë kërkesat apo klauzolat e kushteve te konfiskimit te Sigurimit te tenderit. Kjo e bene sigurimin e tenderit te pa realizueshëm per autoritetin kontraktues ne rast te kërkesës se tije per mospermbushjen e operatorit ekonomik te njëres nga kushtet e specifikuara ne Aneksin 4 te dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues ka kete mendim.

Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate ka ofruar sigurimin e tenderit nga Banka kombetare tregtare (BKT) shuma e te cilët eshte e njejte me ate te kërkuar ne dosjen e tenderit. Mirëpo sigurimi i tenderit te OE fitues nuk i permbane kushtet e parapara me nenin 57 pika 1 te LPP-se. Te njetat kushte janë te parapara edhe ne aneksin 4 te dosjes se tenderit. Këto kushte parashohin rastet kur mundet te behet konfiskimi i sigurimit te tenderit per rastet e caktuara. Fakti qe këto kushte janë vendosur ne dosjen e tenderit nga ana e autoritetit kontraktues, te njëjtat ka qene dashur te përfshihen edhe ne sigurimin e tenderit nga ana e operatoreve ekonomik.

Ne rastet si tani te sigurimi i tenderit te OE fitues kur nuk përfshihen kërkesat e dhëna ne dosjen e tenderit, atëherë neni 57 pika 2 e LPP-se thotë:

"Nëse autoriteti kontraktues vendos një kërkesë për sigurimin e tenderit, kërkesa e tillë do të aplikohet për të gjithë tenderuesit. Autoriteti kontraktues do të refuzojë dhe nuk do të vlerësojë një tender të pranuar nga një tenderues që nuk e ka përmbushur kushtin e depozitimit të sigurisë së tenderit"

Pra autoriteti kontraktues ka vendosur një kërkesë për sigurimin e tenderit dhe operatori ekonomik ankues kur e ka dorzuar ofertën me sigurimin e tenderit, i njëjti sigurim nuk e ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues (klauzolat per konfiskimin e sigurimit).

Autoritetit kontraktues ka qenë dashtë të eliminiminoj ofertën e operatorit ekonomik ankues per shkak se Sigurimi i tenderit nuk eshte ne përputhje me nenin 57 pika 1 të LPP-se.

Po ashtu një rast i tillë është i theksuar edhe te Udhëzuesi Operativ i Prokurimit Publik nenin 39 (Sqarimi i Tenderëve) ku në tabelë janë dhënë rastet si të veprohet për mungesë të dokumenteve dhe të plotësimit të tyre. Shih tabelën e më poshtme që si arsyetim është marrë edhe nga operatori ekonomik ankues.

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
---	---	----

Dokumenti i operatorit ekonomik ankues "Sigurimi i tenderit" nuk e ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues të dhënë në aneksin 4 të dosjes së tenderit "Sigurimi i tenderit". Prandaj ky pretendim ankimor vlerësohet si i **bazuar**.

Përgjigje në Pretendimin nr.3

Lidhur me pretendimin e fundit të OE ankues të paraqitura në ankesë autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 72 të LPP-së (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë) kur ka kërkuar sqarime prej OE fitues lidhur me Deklaratën e specifikimeve teknike, Deklaratën e Liferimit, Deklaratën e Garancionit dhe Deklaratën e Standardit DIN:22102 të cilat deklarata nga OE fitues janë dorzuar me numur të prokurimit për një aktivitet tjetër dhe të njëjtat janë plotësuar dhe dorzuar pas hapjes së ofertave që bie ndesh me nenin 72 të LPP-së, ekspertit shqyrtues ka kete mendim.

Eshte fakt që me oferte OE ekonomik i rekomanduar për kontratë ka dorzuar deklarata të përmendura më lartë për një aktivitet tjetër me nr.KEK-19-125-121, ndërsa gjatë procesit të vlerësimit pas kërkesës për sqarim shtesë të bëre nga autoriteti kontraktues këto deklarata janë përmirësuar dhe dorzuar të autoriteti kontraktues tani me numër të këtij aktiviteti të prokurimit KEK-19-292-111. Këtu shihet qartë që operatori ekonomik fitues ka bëre një gabim teknik me rastin e shkrimit të këtyre deklaratave ku nr. i aktivitetit të prokurimit është shkruar tjetër nga ai për të cilin ka konkuruar. Si do që të jetë, dorzimi i dokumenteve shtesë të cilat mbajnë datën e leshimit pas hapjes së ofertave është në kundërshtim me nenin 72 pika 3 të LPP-së. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i **bazuar**.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Procesi i ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues nuk është bëre në përputhje me nenin 59 të LPP-së sepse oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë ka pasur dobësi serioze në sigurimin e tenderit sepse sigurimi i tenderit të kësaj oferte nuk i ka plotësuar kushtet e nenit 57 të LPP-së dhe nuk ka qene në përputhje me kërkesat e Aneksit 4 të dosjes së tenderit. Pra në kete rast nuk është respektuar nenin 57 të LPP-së.

Po ashtu dobësi ka pasur edhe të pranimit të deklaratave të operatorit ekonomik fitues ku të njëjta janë korrigjuar dhe pranuar pas hapjes së ofertave, veprim që bie ndesh me nenin 72 pika 3 të LPP-së.

Bazuar në përgjigjet e dhëna më lartë gjatë shqyrtimit të kësaj lende, ekspertit shqyrtues e vlerëson si të **bazuar** ankesën e operatorit ekonomik ankues dhe i rekomandon Panelit Shqyrtues që ta **aprovoj** atë. Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues që ta bëjë **Rivleresimin** e ofertave për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me shirit transportues gomë-pëlhurë"** me nr.prokurimi KEK-19-292-111 në bazë të dispozitve të LPP-së.